

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Morali / *el-Khuluk* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Vërtet ti ke një moral të lartë.” (el-Kalem, 4)

Morali është natyra e vërtetë para së cilës shtirësi rrënohet. Teoricienët e kësaj dijeje janë pajtuar se shtegu i pastrimit shpirtëror (*tesawwuf*) i tëri ka të bëjë me moralin e mirë. E tëra kjo vërtitet rreth një boshti: ushtrimi i mirësjelljes dhe përmbajtja nga dëmtimi i të tjerëve. Kjo mund të arrihet nëpërmjet tri cilësive: dijes, dashamirësisë, dhe durimit.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është t’ua dish vendin e krijesave dhe të dish se ato janë të lidhura për fatet e tyre, të kufizuara brenda mundësive që u janë dhënë, dhe të lidhura me caktimin e Tij.² Nga kjo njohje do të fitosh tri gjëra:

- Krijesat do të ndihen të sigurta nga ti, madje dhe qentë³
- Krijesat do të të duan
- Krijesat do të gjejnë shpëtim nëpërmjet teje⁴

Niveli i dytë është përsosja e sjelljeve tua me të Vërtetin, gjë që arrihet duke ditur se:

¹ Dija të udhëzon për atë që është e drejtë dhe e mirë. Dashamirësia të bën të mirë dhe bujar me të gjitha krijesat. Durimi të ndihmon t’i tolerosh dëmet e njerëzve dhe t’i falësh ata.

² Kështu, ti s’do të jesh i ashpër në gjykimin ndaj tyre dhe do t’i justifikosh. Kjo nuk nënkupton pranim dhe normalizim të gjynahut, por vetëm mëshirë ndaj gjynahqarit.

³ Sepse ata e dinë se ti asnjëherë nuk mendon t’i dëmtosh dhe je falës e dashamirës.

⁴ Sepse, kur ata të duan ty, do ta pranojnë më shumë ligjërimin dhe udhëzimin tënd.

- Për çdo gjë që del prej teje duhet të kërkosh falje⁵
- Për çdo që vjen nga i Vërteti duhet të falënderosh
- Domosdoshmërinë e përmbushjes (së marrëveshjes që ke me Të)

Niveli i tretë është:

- Përpunimi i moralit nëpërmjet pastrimit⁶
- Ngritja mbi shpërhapjen e përpunimit të moralit⁷
- Përpunimi i moralit duke tejkeluar (lënë mbrapa) moralin tënd⁸

⁵ Madje edhe për veprat e tua të mira duhet të kërkosh falje, meqë ato nuk janë sa duhet të mira për t'ia paraqitur Atij. Pejgamberi ﷺ kërkonte falje (*istigfar*) menjëherë pas faljes së namazeve.

⁶ Përsosja e moralit duke hequr të gjitha papastërtitë, sidomos papastërtitë e njetit.

⁷ Sepse përqendrimi në përpunimin e moralit mund të të shpërqendrojë nga hyjnorja (i lartësuar qoftë Ai). Nganjëherë (në vend të përpunimit) është më mirë ta ridrejtosh një moral të caktuar duke ia nënshtuar vullnetit hyjnor. Umeri ؓ ridrejtoi ashpërsinë e tij për ta vënë në shërbim të Zotit. Për më shumë, një ndjekës i shtegut të pastrimit shpirtëror ka mundësi ta humbë kohën e çmueshme duke vlarë të gjithë gjarpërinjtë dhe akrepat që sheh rrugës, çka mund ta vonojnë apo dhe ta ndërpresin rrugëtimin e tij. Qëllimi kryesor është t'i shërbesh kauzës së Tij dhe ta kënaqësh Atë.

⁸ Kjo, sipas pikëpamjes së shejhut (el-Harawi), është shkalla apo stacioni përfundimtar, që nënkupton të mos jesh i vetëdijshëm për vetën tënde dhe të jesh i vetëdijshëm vetëm për të Vërtetin, Allahun.